



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AGE GROUP" Sh.P.K. të datës 29.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe renovimi i Lodrave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-26-3166-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AGE GROUP" Sh.P.K. të datës 29.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe renovimi i Lodrave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-26-3166-2-1-1.**
- II. LEJOHET autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.**
- III. NJOFTOHEN palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "AGE GROUP" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 29.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe renovimi i Lodrave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-26-3166-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:  
"I. SHKELJET SPECIFIKE - STAFI INXHINIERIK**

---

**2.1 - Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 5 (pesë) vite përvoj pune. I certifikuar për siguri dhe shendet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. I certifikuar për menaxhim kanieri, I certifikuar për me ISO 9001,14001,45001 dhe 50001 I licencuar nga Oda e Inxhinierëve.**

**Shkelje e drejtpërdrejtë e Nenit 7, 27 dhe Nenit 51**

- Nuk ekziston asnjë aktivitet konstruktiv në këtë kontratë
- Nuk ka projektim, analizë statike apo mbikëqyrje ndërtimore

**Kërkesa është juridikisht e pabazuar dhe funksionalisht e panevojshme, duke tejkaluar çdo standard të proporcionalitetit. Kjo kontratë ka të bëjë me mirëmbajtje lodrash dhe jo:**

- ndërtim objektesh industriale;
- menaxhim fabrikash;
- projekte energjetike;
- sisteme komplekse ISO.

**Kërkesa që një inxhinier individual të posedojë kaq shumë certifikime është:**

- joproporcionale;
- diskriminuese;
- pa lidhje logjike me kontratën.

**ISO 50001 lidhet me menaxhim energjetik dhe nuk ka asnjë lidhje me renovimin e lodrave.**

---

**2.2 - Një (1) inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Arkitekture, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit. I licencuar nga Oda e Arkitekteve**

**Shkelje e Nenit 51**

- Nuk ka projektim arkitektonik në këtë kontratë
- Furnizimi me produkte të gatshme nuk kërkon ekspertizë arkitekturore

**Kjo kërkesë përbën devijim të qëllimshëm nga natyra e kontratës. Objekti i kontratës nuk përfshin projektim arkitektonik të objekteve.**

**Mirëmbajtja e lodrave nuk arsyeton angazhimin e arkitektit të licencuar si kriter obligativ.**

**Kjo kërkesë:**

- kufizon operatorët ekonomikë;
- nuk është proporcionale;
- nuk është e arsyetuar teknikisht.

---

**2.3 - Një (1) Bachelor i Arkitektures, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar me PMP, e Certifikuar për**

**menaxhimin e projekteve I licencuar nga Oda e Arkitekteve per testimin e produkteve. I licencuar nga Oda e Inxhinierëve**  
**Shkelje e Nenit 7, 27 dhe Nenit 51**

Certifikimi PMP përdoret për projekte komplekse ndërkombëtare dhe jo për mirëmbajtje lodrash.  
Po ashtu:

- nuk sqarohet çfarë "testimi produktesh" kërkohet;
- nuk ka bazë ligjore apo teknike për këtë kriter.

Ky kriter është:

- i paqartë;
- diskriminues;
- favorizues për operatorë të caktuar.

---

**2.4 – Nje (1) inxhinier i Elektros, kërkohet të ketë së paku 5 vite përvoj pune i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. I licencuar nga Oda e Inxhinierëve.**

**Shkelje e Nenit 7 dhe Nenit 51**

**Kërkesa është e fryrë artificialisht dhe ligjërisht e pajustificueshme. Kundërshtimi:**

Dosja nuk sqaron:

- çfarë punimesh elektrike do të kryhen;
- pse kërkohet inxhinier i elektros.

Në mungesë të punimeve elektrike substanciale:

- kjo kërkesë është e panevojshme;
- kufizon konkurrencën.

---

**2.5 – Një (1) inxhinier me titull bachelor drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licence valide nga AKK, te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.**  
**Shkelje flagrante e Nenit 7 dhe Nenit 51**

**Kjo kërkesë është plotësisht jashtë objektit të kontratës dhe juridikisht e pavlefshme.**

Mirëmbajtja dhe renovimi i lodrave:

- nuk përfshin matje kadastrale;
- nuk përfshin incizime gjeodezike;
- nuk përfshin parcelim apo punime topografike.

**Kërkesa për gjeodet është krejtësisht jashtë natyrës së kontratës.**

Kjo përbën:

- kriter artificial;
- kufizim të konkurrencës;
- shkelje të proporcionalitetit.

---

**2.6 – Një (1) inxhinier i diplomuar I ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi Infrastrukturë rrugore), kërkohet të ketë min. 10 vite përvojë pune në angazhime**

**profesionale pas diplomimit I certifikuar për menaxhimin e projekteve dhe të jete i pajisur me Certifikatë për siguri rrugore.**  
**Shkelje e Nenit 7, 27 dhe Nenit 51**

**Kërkesa përbën tejkalim të kompetencave të autoritetit kontraktues.**

**Kjo kërkesë është ndër më diskriminueset në dosje.**

**Kontrata nuk ka të bëjë me:**

- rrugë;
- autostrada;
- sinjalizim rrugor;
- infrastrukturë trafiku.

**Kërkesa për ekspert të sigurisë rrugore në një kontratë për lodra është:**

- absurdisht joproporcionale;
- pa asnjë lidhje funksionale me objektin e kontratës.

---

**2.8 – Një(1) Person të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri.**

**Shkelje e Nenit 7 (proporcionaliteti)**

**Kjo kërkesa është e panevojshme dhe diskriminuese.**

**Dosja nuk përfshin:**

- kanalizime;
- drenazhim;
- sisteme ujërash.

**Kjo kërkesë është jashtë objektit të kontratës.**

---

**2.9 – Tre(3) Person të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës si dhe të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri.**

**Shkelje e Nenit 51 dhe 60**

**Kjo kërkesë është pa bazë reale.**

**Autoriteti kontraktues ka kërkuar numër të madh të mekanizimit të rëndë pa arsyetim teknik.**

**Numri i kërkuar i operatorëve:**

- tejkalon nevojën reale;
- favorizon kompani infrastrukturore.

**2.10 – Nje (1) Person të trajnuar për saldim iws dhe testim sipas EN ISO 9712 2012 ose ekuivalent. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri.**

**Shkelje e nenit 51**

**Standardi EN ISO 9712 përdoret për testime industriale jo-shkatërruese në industri të avancuara.**

**Kjo nuk ka lidhje me renovimin standard të lodrave urbane.**

Kërkesa është:

- e ekzagjeruar;
- joproportionale;
- kufizuese.

---

#### IV. RAPORTI I RISKUT

Shkelje e Nenit 28

- Nuk ka vend pune industrial apo kantier
- Nuk ka ekspozim ndaj rrezikut operacional

Kërkesa është e pajustificueshme dhe e vendosur në mënyrë mekanike pa analizë reale.

---

#### II. CERTIFIKIMET ISO

Shkelje e Nenit 27 dhe Nenit 51

Kërkesa për:

Certifikimi EN- 1090-1 2009+A1 2011 ISO 3834-2 2021; ISO 4063 2023; ISO 9001 2015 ;ISO 14001 2015 ; ISO 28001 2007; ISO 39001 2012; ISO 45001 2018. Ose ekuivalent.

Këto standarde lidhen me:

- konstruksione çeliku;
- procese industriale saldimi;
- zinxhir furnizimi;
- siguri në transport rrugor.

Objekti i kontratës nuk justifikon këto standarde.

ISO 39001 për siguri në trafik rrugor nuk ka asnjë lidhje me mirëmbajtjen e lodrave.

ISO 28001 lidhet me sigurinë në zinxhirin global të furnizimit dhe është krejtësisht irrelevant.

Kërkesat:

- kufizojnë konkurrencën;
- favorizojnë operatorë të mëdhenj;
- janë diskriminuese.

#### III. MAKINERITË – SHKELJE SISTEMATIKE

Të gjitha pajisjet e kërkuara janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- Nenin 51 – kriteret e përzgjedhjes
- Nenin 7 – disproporcion ekstrem

Ekskavatorë, damperë, rul vibrues, kamionë kiper, pajisje për kubeza etj.

Këto pajisje përdoren për:

- ndërtim rrugësh;
- infrastrukturë të rëndë;

- punime industriale;
- terrene masive ndërtimore.

Renovimi i lodrave nuk kërkon:

- flotë infrastrukture;
- mekanizëm të rëndë;
- pajisje për kubeza betoni industriale.

Kriteret janë:

- joproportionale;
- diskriminuese;
- penguese për konkurrencën”.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit**, është gjetur se kërkesat për stafin profesional konkretisht për stafin, ISO, makinerinë janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njëzia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njëzia kërkuese.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 01.06.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.